



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0607

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105, 106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga: Agon Ramadani- Kryetar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) “Advanced Group of Architecture” SH.P.K. lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “Punim i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale per ndërtimin e objektit te Gjykates Themelore Peje “me nr. të prokurimit: "328-23-6142-2-2-3", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Këshilli Gjyqësor i Kosoves, me datën 31.10.2023, morri këtë:

Vendim

I. Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik “Advanced Group of Architecture” SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 22.08.2023 (me numër protokolli 607/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Punim i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale per ndërtimin e objektit te Gjykates Themelore Peje“ me nr. të prokurimit: "328-23-6142-2-2-3", iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Keshilli Gjyqesor i Kosoves.

II. Të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-se, dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

III. Lejohet kthimi i shumës së deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës dhe obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

- Faktet dhe rrethanat procedurale –

Me 16.06.2023, Keshilli Gjyqesor i Kosoves , në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin për Konkursin e Projektimit për aktivitetin e prokurimit me titull: “Punim i projektit

kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale per ndërtimin e objektit te Gjykates Themelore Peje” me nr. të prokurimit: "328-23-6142-2-2-3". Nderkaq me datën 09.08.2023 eshte publikuar njoftimi mbi vendimin e AK.

OE “Advanced Group of Architecture” SH.P.K me datën 14.08.2023 ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK. AK- Keshilli Gjyqesor i Kosoves me vendim ka refuzuar kërkesën per rishqyrtim te OE “Advanced Group of Architecture” SH.P.K. . lidhur me aktivitetin e prokurimit “Punim i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale per ndërtimin e objektit te Gjykates Themelore Peje” me numër te prokurimit: 328-23-6142-2-2-3 inicuar nga Autoriteti Kontraktues.

AK ne vendim ka kërkuar te mbetet ne fuqi njoftimi mbi vendimin per dhënie i AK, lidhur me aktivitetin e prokurimit “Punim i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale per ndërtimin e objektit te Gjykates Themelore Peje” me numër te prokurimit: 328-23-6142-2-2-3

I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE ankues“Advanced Group of Architecture” SH.P.K. me datën 22.08.2023 ka parashtruar ankesë në OSHP, me numër të protokollit 607/23, kundër vendimit të Autoritetit Kontraktues lidhur me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër.

Autoriteti kontraktues ka zbatuar procedure te hapur, lloji i kontratës: sherbim, vlere e parashikuar e kontratës: 80.000.00 € .

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me këtë, me 11.09.2023 eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE “Advanced Group of Architecture” SH.P.K.

I. Aprovohet, si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik“Advanced Group of Architecture” SH.P.K., e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 22.08.2023 (me numër protokollit 607/23) për aktivitetin e prokurimit me titull: “Punim i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale per ndërtimin e objektit te Gjykates Themelore Peje“ me nr. të prokurimit: "328-23-6142-2-2-3", inicuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) – Keshilli Gjyqesor i Kosoves.

II. Të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-se, dhe lënda te kthehet ne rivlerësim.

REKOMANDIMI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, kriteret e dhëna ne dosjen e tenderit për vlerësimin e ofertave dhe rëndësisë së fakteve të gjetura gjatë shqyrtimit të projektit ideor, të cilat mund të ndikojnë në procesin e vlerësimit të ofertave dhe ndryshimin e renditjes së poentimit, eksperti teknik i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues të **aprovohet si e bazuar**, të anulohet njoftimi mbi vendimin e AK-së dhe rekomandon që lënda të kthehet në rivlerësim.

Faktet e gjetura - pretendimet e bazuara, duhet të merren parasysh nga AK dhe të merren për bazë në procesin e vlerësimit sipas kriterëve të vlerësimit dhe poentimit të përcaktuara në dosjen e tenderit.

Sqarim Shtesë për Panelin shqyrtues:

Rregullorja për Prokurim Publik 001/2022 jep sqarime në lidhje me përdorimin e konkursit të projektimit:

Përdorimi i konkursit për projektim

55.5 Konkursi për projektim mund të përdoret për çfarëdo projekti në të cilin autoriteti kontraktues mbështetet në kandidatët që ata të furnizojnë zgjidhjet për ndonjë kërkesë të veçantë që mund të paraqitet në një plan, projektim, skicë skematike, model apo formë tjera vizuale.

55.6 Konkursi i projektimit është i kufizuar në marrjen e planit ose projektimit për një projekt, qoftë me ose pa tekst mbështetës apo shpjegim, për të cilin autoriteti kontraktues ka vetëm disa kushte bazike.

55.7 Procedura nuk mund të përdoret për furnizimin e shërbimeve.

Aty ku kërkohen punimet apo shërbimet me qëllim që të zbatohet projektimi, atëherë kontrata për ekzekutimin e shërbimeve apo punimeve duhet të jepet veçmas.

Në këtë rast AK ka përdorur konkurs projektimi duke përfshirë edhe shërbimet e mbikëqyrjes së realizimit të projektit.

-Konstatimet e Panelit Shqyrtues-

Paneli Shqyrtues, administroi të gjitha shkresat e kësaj lënde, përfshirë aktet dhe veprimet e AK, parashtrës dhe provat e ankuesit dhe raportin e ekspertit shqyrtues dhe duke i analizuar të gjitha ato në kontekstin e përgjithshëm të kësaj çështje ka krijuar bindjen e pavarur të tij/sajë, se AK nuk vepron konform dispozitave të cituara si raportin e ekspertizës, Në këtë rast Paneli shpjegon se raporti i ekspertizës është hartuar në mënyrë profesionale dhe i njëjti i përmban të gjitha pohimet ankimore dhe analizat lidhur me to, duke i shpjeguar në mënyrë specifike në raport me dispozitat e shkelura, sikurse kërkohet kjo së paku me dispozitën e nenit 113 dhe 114 të LPP-së. Raporti i ekspertit shqyrtues nuk prodhon efekte detyruese për asnjërën nga palët dhe as për panelin shqyrtues, prandaj i njëjti (natyrisht dhe vlerat provuese të tij) gjithnjë analizohen në raport me të gjitha shkresat e një lënde, me rrjedhën e procesit të prokurimit, veprimet e palëve, qëllimin dhe natyrën e një aktivitetit të prokurimit, i cili në parim synon përmbushjen e nevojave publike, me përdorimin e fondeve publike, të cilat i janë besuar secilit AK, në cilin do nivel. Andaj, paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues, deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe administrimit të provave në tërësi,

e të gjithë aktivitetit të prokurimit të lartë shënuar, konsideron se gjetjet e ekspertit shqyrtues dhe mendimi i tij janë të pranueshme nga ana e këtij paneli, andaj është arritur deri tek vendim-marrja përfundimtare që aktiviteti kthehet në rivlerësim dhe i njëjti të rivlerësohet në relacion me pretendimet e paraqitura si dhe shtjellimet e mëposhtme.

Prandaj duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyrë të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër, e posaçërisht duke i kushtuar kujdesin e duhur po ashtu dhe natyrës dhe qëllimit të pretendimeve ankimore, Paneli Shqyrtues mori në konsideratë të gjitha pohimet e ankuesit, aktet dhe veprimet e ndërmarra nga AK, raportin e ekspertit shqyrtues dhe i analizoi me kujdes të gjitha shkresat e kësaj lënde dhe konsideron se pohimet ankimore të OE ankues detyrojnë Panelin që lënda duhet të kthehet në rivlerësim për dy arsye themelore, të cilat qëndrojnë mbi faktet e evidentuara në rrjedhën e këtij aktiviteti, lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura në aspektin teknik të vlerësimit të ofertave, në kërkesën për rishqyrtim AK nuk ka ofruar fakte argumente shpjegime të cilat vërtetojnë gjendjen faktike në kundërshtim që pretendimet ankimore të klasifikohen si të pabazuara, duke mos arsyetuar dhe kthyer përgjigje lidhur me pretendimet ankimore të paraqitura në kërkesë për rishqyrtim, e po ashtu në përgjigjet e dhëna në raportin e ekspertizës po ashtu paneli nuk ka arritur të evidentojë përgjigjet konkrete rreth pretendimeve ankimore, andaj në mungesë të argumentimeve, përgjigjeve, fakteve dhe provave të ofruara nga ana e AK-së është arritur deri tek vendim-marrja sikurse në dispozitiv, për faktin se veprimet e tilla bien ndesh me legjislacionin në fuqi, konkretisht të paktën siç kërkohet me nenin 108/a, që vendimi ndaj kërkesës për rishqyrtim duhet të arsyetohet, përveç tjerash edhe Ligji për Procedurën e Përgjithshme Administrative, konkretisht Neni 48 i LPPA-së, specifikon:

3.1. Vendimi i paarsyetuar

"1. Arsyetimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsyetimi përmban:

1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës;

1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi;

1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave;

1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyen pse është e zbatueshme në rastin konkret;

1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve;

1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim.

2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e tij

Andaj, duke u bazuar në të gjithat që u thanë si më sipër, Paneli shqyrtues konsideron se vendimi i marrë lidhur me këtë pikë është i bazuar në administrimin e të gjitha provave në dispozicion të kësaj lënde.

Si arsye tjetër që ka orientuar drejt vendim-marrjes sikurse në dispozitiv, ka qenë çështja e ngritur nga ana e ekspertit sa i përket qëllimit të kontratës relevante, që sipas titullit të aktivitetit

të prokurimit i cili është “Punim i projektit kryesor dhe mbikëqyrjes profesionale për ndërtimin e objektit të Gjykatës Themelore Peje” ku len të që të nënkuptohet që ky aktivitet parasheh projektim dhe mbikëqyrje, andaj eksperti me të drejtë i ju është referuar Rregullores për Prokurim Publik 001/2022, në bazë së cilës specifikohet përdorimi i konkursit të projektimit:

Përdorimi i konkursit për projektim

55.5 Konkursi për projektim mund të përdoret për çfarëdo projekti në të cilin autoriteti kontraktues mbështetet në kandidatët që ata të furnizojnë zgjidhjet për ndonjë kërkesë të veçantë që mund të paraqitet në një plan, projektim, skicë skematike, model apo formë tjera vizuale.

55.6 Konkursi i projektimit është i kufizuar në marrjen e planit ose projektimit për një projekt, qoftë me ose pa tekst mbështetës apo shpjegim, për të cilin autoriteti kontraktues ka vetëm disa kushte bazike.

55.7 Procedura nuk mund të përdoret për furnizimin e shërbimeve.

Aty ku kërkohen punimet apo shërbimet me qëllim që të zbatohet projektimi, atëherë kontrata për ekzekutimin e shërbimeve apo punimeve duhet të jepet veçmas.

Sipas ekspertit shqyrtues, në këtë rast AK ka përdorur konkurs projektimi duke përfshirë edhe shërbimet e mbikëqyrjes së realizimit të projektit.

Kështu që lidhur me këtë, me qenë se aktiviteti kthehet në rivlerësim, AK duhet të marrë në konsideratë dispozitën e lartpërmendur dhe të vërtetojë gjendjen faktike se a parashihet edhe mbikëqyrja e këtij projekti me kontratën e njëjtë si dhe nëse dispozita e mësipërme aplikohet në rastin konkret, dhe pas shqyrtimit dhe vërtetimit nëse dispozita e mësipërme aplikohet në aktivitetin konkret, mbetet në përgjegjësi që AK të veprojë konform këtyre neneve dhe eventualisht në bazë të diskrecionit dhe rezultatit të ofruar dhe të vërtetuar, të anulojë në tërësi apo të vazhdojë me aktivitetin bazuar në të gjeturat dhe gjendjen faktike, konform nenit 62 të LPP-së.

Prandaj duke vepruar në pajtim me kompetencat e cituara si më sipër dhe nenin 104 paragrafi 4 lidhur me paragrafin 1, sipas të cilit procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e ligjshme dhe efektive të lëndës, si dhe duke ju referuar nenit 117 të LPP-së, dhe në provat e prezantuara si më lartë Paneli Shqyrtues vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Për pikën I të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 117 të LPP lidhur me nenin 29 të Rregullores së Punës së OSHP.

Për pikën II dhe III të vendimit është vendosur duke u bazuar në nenin 118 të LPP lidhur me nenin 31 paragrafin 1 dhe 6 të Rregullores së Punës së OSHP.

Nga sa u tha më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Kryetar i Panelit Shqyrtues

Agon Ramadani

Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me padi ka të drejtë t'i drejtohet Gjykatës Komerciale në Prishtinë, në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - Këshilli Gjyqësor i Kosovës**
- **OE - Advanced Group of Architecture SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: